



# Republika e Kosovës

## Kuvendi Komunës së Malishevës



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVA  
KUVENDI KOMUNËS SË MALISHEVËS  
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVO



PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Nr.No.Bi:

30.01.2020

01/79

Nr. 01/79  
Datë: 30/01/2020

Në mbështetje të nenit 68 paragrafi 3 të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr: 28, nenit 12 dhe 22 të Rregullores së MF, nr: 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Malishevës kërkesa nr.01/21, dt.13.01.2020, në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit të Komunës, bëjnë:

### THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Ftohen organizatat joqeveritare të sferës së shërbimeve publike sociale dhe familjare, që janë aktive dhe zhvillojnë aktivitetet e tyre në komunën e Malishevës, se mundë të aplikojnë me projektet e tyre për përkrahje financiare nga Komuna e Malishevës për vitin 2020 .

Dokumentet e kërkuara për aplikim:

1. Projekt-propozimi,
2. Aplikacioni,
3. Dokumenti identifikues,
4. Licencë për personat juridik,
5. Certifikata e regjistrimit (për personat juridik),
6. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë (për persona fizik),
7. Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridik),
8. Konfirmimin nga banka për xhironlogarinë e aplikuesit,

Komuna e Malishevës, do të ndajë mjete financiare për shërbime shëndetësore shtëpiake.

Shërbimet të cilat ofrohen sipas kësaj thirrje publike, përfshinë;

1. Përkujdesi shtëpiak, vizita shtëpiake,
2. Transporti i pacientëve me regjim-dialize,
3. Transporti i pacientëve me aftësi të kufizuar,
4. Pajisje për personat me aftësi të kufizuar.

Ofruesi i shërbimeve duhet të jetë i licencuar nga organet kompetente, në lidhje me kryerjen e shërbimeve të lartcekura.

Mbështetje financiare do të ofrohet varësisht nga vlerësimi i projektit nga Komisioni dhe mundësitë buxhetore të Komunës.

Tërheqja dhe dorëzimi i aplikacionit mund të bëhet në ndërtesën e Komunës, kati i parë, në Qendrën për Shërbime për Qytetarët.

Aplikacionet e pa kompletuara nuk do të shqyrtohen.

Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në zarf të mbyllur, ku brenda zarfit vendoset një kopje e printuar e të gjithë dokumentacionit original të kërkuar.

**Aplikuesit mund ta dorëzojnë dokumentacionin brenda afatit prej 15 ditë pune nga dita e shpalljes në ueb faqen e Komunës, tabelën e shpalljeve të KK-Malishevës.**

Kryetari i Komunës  
Ragip Bega

